

 PËRDOR
TEKNOLOGJINË



PËRMIRËSO
DEMOKRACINË



**NJIHUNI ME DISA PLATFORMA
TË DEMOKRACISË DIGJITALE**

PËRMIRËSO DEMOKRACINË PËRDOR TEKNOLOGJINË

Ky produkt u realizua nga Qendra A.IA në kuadër të projektit “Përdor teknologjinë, përmirëso demokracinë!” me mbështetjen financiare të Leviz Albania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Financuar nga LevizAlbania

LEVIZ
Albania

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HYRJE

Angazhimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve janë tiparet kryesore të një shoqërie demokratike. Teknologjitë digjitale kanë transformuar mënyrën se si jetojmë dhe punojmë duke forcuar ndjeshëm pjesëmarrjen qytetare në hapsirën virtuale. Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK), luan sot një rol gjithnjë e më të rëndësishëm edhe në ndërveprimin mes autoritetit publik dhe qytetarëve duke eliminuar distancat / largësinë gjeografike e duke reduktuar kështu shpenzimet, duke lejuar marrëdhënie të vazhdueshme me përfaqësuesit e zgjedhur në nivel vendor, duke mos ndalur shërbimet edhe në kohë krizash apo fatkeqësish, siç është pandemia e Covid-19.

Teknologjia na ka mundësuar një sërë mjeteve dhe instrumentesh për të praktikuar demokracinë në mënyrë digjitale gjë që ka rezultuar të jetë efektive edhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies të sektorit publik.



Çfarë është demokracia digjitale (e-demokracia)?

Demokracia digjitale përfshin përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në mbështetje të proceseve demokratike me në qendër qytetarin. Kjo ndihmon në pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse dhe transparencën e veprimtarisë administrative. Demokracia digjitale ofron mundësi për të votuar elektronikisht si shprehje e demokracisë pjesëmarrëse, psh. nënshkrimi i peticioneve në mënyrë elektronike; për të treguar opinionin publik (si p.sh. nëpërmjet plotësimit të anketave / pyetësorëve të ndryshëm dhe sondazheve në internet, duke shprehur kështu mendimin tuaj për një çështje të caktuar); për ndërtimin e komuniteteve online, në ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për përmirësimin e komunitetit tuaj dhe adresimin e çështjeve të përbashkëta; gjithashtu, demokracia digjitale ofron hapësira të diskutimit në faqet online (website) për të stimuluar diskutimin dhe debatin publik online, e cila ju mundëson të zhvilloni diskutime dhe komunikime me aktorë të ndryshëm si; përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore, organizata të shoqërisë civile, pjestarë të tjerë të komunitetit.

Qytetarët kanë tashmë në dorë një sërë instrumentesh të demokracisë digjitale të cilat mund t'i përdorin për t'u informuar mbi aspekte të ndryshme të qeverisjes lokale, për të komunikuar problematikat tuaja me autoritetet vendore, për të rritur angazhimin dhe pjesëmarrjen tuaj në politikëbërje etj. Më poshtë do të gjeni të listuara disa prej tyre dhe qëllimin që ka secila platformë.



Platforma të demokracisë digjitale

01 Faqet web të bashkive (Durrës, Shijak, Krujë), dhe mënyra e aksesimit të tyre¹

Për efekt të shtrirjes gjeografike të iniciativës “Përdor teknologjinë, përmirëso demokracinë!”, në fokus të këtij moduli do të jenë faqet web të bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë. Faqet zyrtare të këtyre bashkive kanë për qëllim të ofrojnë informacion për qytetarët lokalë mbi organizimin, veprimtarinë e njësive vendore, shërbimet publike që ata ofrojnë, aktet që nxjerrin organet e njësive të qeverisjes vendore, dokumentacionin e kërkuar për veprimtari të ndryshme, si dhe formate / formularë online për të lehtësuar shërbimet ndaj qytetarëve dhe ndërveprimin mes tyre. Në faqet web të bashkive pasqyrohet si pjesë e detyrimit ligjor programi i transparencës, koordinatori për të drejtën e informimit, modalitetet e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje dhe inisiativa qytetare, konsultimi publik, si dhe në raste të caktuara platforma komunikimi me qytetarët. Kështu **në bashkinë Durrës** përmendim linjën e këshillimit online “Unë të dëgjoj”, forumi online për qytetarët www.durres.gov.al/kerkese-per-informacion si dhe Platforma “Aplikimi online-“Shtëpia ime” si një platformë online për aplikimin e përfutësve nga programi i rindërtimit.

¹ Faqet web të këtyre bashkive: www.durres.gov.al; www.shijak.gov.al; <https://kruja.gov.al>


Në bashkinë Shijak përmendim p.sh.hapsirën “Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje”; www.shijak.gov.al/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje, www.shijak.gov.al/konsultime-publike-2;
 Në bashkinë Krujë: <https://kruja.gov.al/programi-i-transparences>; <https://kruja.gov.al/dergo-ankese-dhe-kerkese>.

02 Portali e-albania²

Portali qeveritar shumë funksional e-albania.al mundëson që çdo person i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit, shërbime elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri. Ky portal është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë mbi të cilën mundësohet ndërveprimi me sistemet elektronike të institucioneve publike. E-Albania është një zyrë me një ndalesë për shërbimet online të administratës publike. Gjithashtu ky portal ofron informacion për qytetarin si dhe dokumentacionin e nevojshëm, procedurën që duhet të ndjekë, oraret e funksionimit dhe vendndodhjen e zyrave të administratës, kontaktet, si dhe adresën e faqes zyrtare të institucionit që ofron shërbimin përkatës, ku qytetari mund të orientohet për detaje të mëtejshme. Po ashtu portali ofron mundësi komunikimi për çdo paqartësi, pyetje apo problem mbi regjistrimin, shërbimet e ofruara në portal, përmes forumit të portalit, postës elektronike, komenteve dhe mesazheve në rrjetet sociale³. Kjo është një platformë online ku sot çdo qytetar apo biznes mund të logohen nga ID personale. Në këtë platformë ju merrni të gjithë shërbimet në telefonin apo kompjuterin tuaj personal.


² Linku për të aksesuar këtë portal: <https://e-albania.al/>

³ <https://e-albania.al/Pages/eAlbania.aspx>



Përmes këtij portali, së fundmi qeveria aplikoi pyetesorin Këshillimi Kombëtar “Le të dëgjojmë njëri-tjetrin” me disa tematika kryesore, rezultatet e të cilit synojnë të përmirësojnë qeverisjen nga ana e institucioneve shqiptare, si dhe të adresohen problematikat kryesore që shqetësojnë shqiptarët.

03 Platforma Open Data Albania⁴




Open Data Albania është një platformë e cila ka për qëllim të mbledhë dhe të ruajë të dhëna mbi indikatorët ekonomik-shoqërorë në Shqipëri. Kjo platformë mbledh, përpunon dhe publikon të dhëna nga disa zyra publike shqiptare. Të dhënat që ofrohen përmes kësaj platforme janë me rëndësi në lidhje me transparencën dhe kontrollin e aktiviteteve të ndryshme publike. Kjo platformë është pjesë e programeve të transparencës të ndërmarra ndaj qeverive dhe zyrave publike në mjaft vende të ndryshme të botës nëpërmjet publikimit të të dhënave “Open Data” në internet.

⁴ Linku për të aksesuar platformën Open Data Albania: <https://ndiqparate.al/?cat=668>


04 Platforma QytetariN⁵

Kjo platformë ka për qëllim të rrisë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen e Këshillave të Bashkive Tiranë, Durrës dhe Kurbin duke fuqizuar qytetarët, organizatat dhe grupet e interesit për të luajtur një rol aktiv në përcaktimin e përparësive zhvillimore të komunitetit dhe territorit ku ata banojnë apo punojnë duke ndërmarrë peticione dhe iniciativa të ndryshme. Përmes kësaj platforme synohet forcimi i demokracisë vendore dhe inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Bashkisë, si dhe në influencimin e axhendën qeverisëse të Bashkisë. Në këtë platformë mund të zgjidhni të merrni pjesë në peticione që janë aktive si dhe të shfletoni rreth iniciativave të realizuara.



⁵ Linku për të aksesuar këtë portal: <https://qytetarin.com>

05 Porta Vendore.al




Platforma multi-funksionale në mbështetje të demokracisë në nivel vendor është nismë e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Leviz Albania e realizuar me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, e cila synon të vihet në shërbim të informimit të qytetarëve në lidhje me funksionet, kompetencat dhe të dhënat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Këtu do gjeni informacion për përgjegjësitë që kanë bashkitë, shërbimet administrative në nivel vendor, mund të raportoni probleme të ndryshme dhe të konsultoheni me juristë për çështje ligjore.

06 Portali PyetShtetin.al⁶

Portali “PyetShtetin.al” është një iniciativë e përbashkët e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Ky portal synon t’i vijë në ndihmë të gjithë qytetarëve për të gjetur me lehtësi informacione me karakter publik të hartuara nga të gjithë autoritetet publike në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Portali mundëson që çdo qytetar apo / dhe çdo grup interesi të mund të dërgojnë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesat pranë institucioneve shtetërore përgjegjëse si dhe


⁶ Linku për të aksesuar këtë portal: <https://regjistri.pyetshtetin.al/home>



mund të dërgojë ankesa në rast refuzimi të informacionit të kërkuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky sistem synon të lehtësojë aksesin e qytetarëve apo / dhe çdo grupi interesi për informacion publik si dhe të rrisë cilësinë e shërbimit duke ofruar mundësinë për të marrë informacionin publik në një kohë më të shkurtër. Nëpërmjet këtij sistemi mund të gjurmohet statusi i kërkesës nëpërmjet kanaleve informative. Ky sistem aktualisht është instaluar dhe po funksionon në 145 institucione.


07 Platforma Opendata.gov.al⁷

Ky është portali i të dhënave të hapura për Shqipërinë. Përmes këtij portali merren të dhëna, informacion dhe dokumenta në kuadër të nismës “Partneriteti për Qeverisjen e Hapur”. Një rubrikë e veçantë në këtë portal i dedikohet konsultimit publik.




⁷ Linku për të aksesuar këtë portal: Portali i të dhënave të hapura - OpenData <https://opendata.gov.al>

08 Platforma Përmirëso Qytetin⁸



Kjo platformë synon t'u vijë në ndihmë qytetarëve për të përmirësuar cilësinë e jetës në lagjen dhe komunitetin ku jetojnë. Platforma ‘Përmirëso Qytetin’ është krijuar për të zgjidhur sa më shpejt problemet dhe për të afruar qytetarin me bashkinë. Këtu qytetari mund të dërgojë ankesën në mënyrë elektronike direkt nëpërmjet kompjuterit apo celularit të tij dhe të marrë përgjigje sa më shpejt për problemin.

09 Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (konsultimipublik.gov.al)




Për efekt të qeverisjes transparente dhe llogaridhënies, si dhe për të pasur një komunikim më të hapur me qytetarët dhe shoqërinë civile, AKSHI ka implementuar Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në adresën konsultimi publik.gov.al. Kjo platformë do të shërbejë si një mundësi konsultimi mes qytetarëve dhe institucioneve vendimmarrëse në Shqipëri. Ky regjistër elektronik tashmë është pjesë integrale e portalit e-albania, duke lehtësuar kështu aksesin dhe komunikimin me qytetarët.

⁸ Linku për të aksesuar: www.permiresoqytetin.al

10 Platforma Kombëtare vendime.al⁹

Kjo platformë mundëson publikimin online të vendimeve të marra nga 61 këshillat bashkiakë të Republikës së Shqipërisë. Platforma përfaqëson Arkivën Kombëtare të Akteve Legjislative të Pushtetit Vendor për të 61 bashkitë e vendit referuar ndarjes aktuale administrative-territoriale. Përmes VENDIME.AL kushdo njihet shpejt, në çdo kohë dhe pa pagesë me vendimet e këshillit bashkiak. Publikimi i vendimeve dhe njoftimi i tyre efektiv është një detyrim ligjor që buron nga ligji i ri 139/2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”. Kjo platformë i shërben bashkive të Shqipërisë për të realizuar njoftimin e vendimmarrjes së tyre, si dhe i shërben të gjithë qytetarëve, subjekteve juridike dhe fizike nën juridiksionin e bashkisë, duke iu mundësuar atyre njohjen efektive të legjislacionit vendor. Përmes kompjuterit ose celularit vendimet e reja hapen ose shkarkohen në çdo kohë nga administratori ose stafi i NJA dhe mund t'i vihen në dispozicion çdo të interesuari, pa qenë nevoja të ndërmerret një udhëtim i posaçëm në qendrën urbane ku ndodhet bashkia. Kjo platformë gjithashtu i shërben të gjithë aktorëve të tjerë të interesuar në nxitjen dhe promovimin e vendimmarrjes vendore përmes inovacionit dhe teknologjive TIK, të cilat ofrojnë shpejtësi në dhënien/shpërndarjen e informacionit, reduktim të kontaktit mes zyrtarëve dhe publikut si dhe mbulim të gjerë.



⁹ <https://www.vendime.al>

PLATFORMA

E-DEMOKRACIA

TASHMË EDHE NË



Për të mësuar më shumë mbi mënyrën e aksesimit të platformave të sipër përmendura, ju ftojmë të ndiqni videon **Prezantimi i platformave ekzistuese dhe shpjegimi mbi mënyrën e përdorimit të tyre.**

 PËRDOR
TEKNOLOGJINË



**PËRMIRËSO
DEMOKRACINË**